

UNIVERSITETI “MARIN BARLETI”

Strategjia e Klubeve Studentore

Strategjia e klubeve studentore përshkruan një sërë nismash konkrete për të ndihmuar të rinjtë që të përballen me mundësitë dhe sfidat në:

1. **Kulturë, media dhe teknologjitë e reja.**
2. **Botën Studentore**
3. **Edukim dhe trajnim**
4. **Vullnetarizmin shoqëror**
5. **Sipërmarrjen studentore**
6. **Demokraci dhe ligj**
7. **Debat dhe pjesmarrje politike**

Kultura, Media dhe Teknologjitë e Reja. Misioni i klubit “Kultura, media dhe teknologjitë e reja” është ndihmesa e studentëve në zbulimin dhe zhvillimin e talentit të tyre në fushën mediatike, përmes përfshirjes praktike në fushën e larmishme të mediave dhe të teknologjive më të reja. Qëllimi i këtij klubi është krijimi i një mjedisi ku studentët mund të vlerësojnë, krahasojnë e zhvillojnë aftësitë dhe ambicjet e tyre në këtë fushë, përmes përvojës dhe bashkëpunimit me aktorët më në zë të tregut mediatik. Klubi shërben si një urë lidhëse midis kompanive mediatike e teknologjike pararojë dhe studentëve tanë më premtues.

Bota Studentore. Misioni i klubit “Bota studentore” është informimi dhe rritja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete të fushave të tilla si arsimit, zhvillimi i qëndrueshëm, kultura e sportit etj. duke promovuar kështu tolerancën dhe luftuar diskriminimin. Qëllimi i këtij klubi është të krijojë një mjedis ku studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre si qytetarë të mirë e anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit përmes veprimtarive që sjellin nxitje kulturore, intelektuale, arsimore e sociale dhe që sigurojnë bashkëpunimin e studentëve tanë me komunitetin në përgjithësi. Klubi i mbështet studentët e UMB-së në përfshirjen në jetën studentore në kampus dhe në aktivitete kurrikulare të ofruara prej universitetit apo bashkudhëtarëve të tij, nga të cilat të përfitojnë përvoja të frytshme për t’u përdorur edhe jashtë kampusit. Bota studentore është klubi që i përgatit studentët për të ardhmen dhe sidomos për të qenë qytetarë të mirë evropianë ku çdo gjë bazohet në ndërthurjen e të domosdoshmes me të bukurën, duke promovuar normat morale, ligjore dhe shoqërore të një individi të përshtatshëm për këtë epokë të re që po përjeton vendi ynë.

Edukimi dhe trajnimi. Misioni i klubit “Edukimi dhe trajnimi” është mundësimi i aksesit të barabartë të të rinjve në një arsim me cilësi të lartë, si dhe trajnimi i bazuar në mendësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Qëllimi i këtij klubi është orientimi dhe trajnimi sipas interesave dhe aspiratave të të rinjve, drejt një tregu pune të së nesërme në përshtatje me arsimin dhe trajnimet e marra.

Vullnetarizmi në shoqëri. Misioni i klubit “Vullnetarizmi në shoqëri” është zhvillimi dhe kultivimi i ndjenjave njerëzore, si dashamirësia, dhembshuria, bamirësia, përvullësia, krenaria dhe toleranca, për t’i shërbyer të mirës së përbashkët dhe interesit publik. Qëllimi i këtij klubi, është krijimi i një grupi studentësh vullnetarë, për t’i ardhur në ndihmë komuniteteve në nevojë, përmes veprimtarive me interes për shoqërinë. Klubi i mbështet studentët e UMB-së në përfshirjen në aktivitete ku si shpërblim përfitohet ndenja e përkatësisë individuale e kolektive edhe jashtë rrethit shoqëror ku ata jetojnë e studiojnë.

Sipërmarrja Studentore. Misioni i klubit “Sipërmarrje studentore” është integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punonjës, sipërmarrës, e studiues, brenda kornizave të biznesit. Qëllimi i këtij klubi të themeluar si përgjigje kombëtare ndaj trendit ndërkombëtar të strukturave të ngjashme, është sjellja e risive në ide, organizim e përkushtim, gjatë hartimit të planeve të biznesit, këshillimit konstruktiv dhe udhëheqjes, praktikës në terren e rrjeteve brenda sferës së sipërmarrjes. Klubi mbështet dialogun midis studentëve, sektorit privat, atij publik dhe shoqërisë në tërësi, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, seminareve, konferencave dhe botimeve në fushën e sipërmarrjes.

Demokraci dhe ligj. Misioni i klubit “Demokraci dhe ligj” është zgjerimi i kulturës juridike të studentëve të “Universitetit Marin Barleti” e më gjerë, nëpërmjet interpretimit të jurisprudencës së gjykatave shqiptare e të atyre ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet organizimit të aktiviteteve mbi diskutimin e tendencave të ligjit dhe të shtetit të së drejtës, me profesionistë të shquar së drejtës. Ky klub ka për qëllim të nxisë aftësitë analitike dhe komunikuese, ndershmërinë, koherencën dhe zbatimin e ligji. Klubi mundëson pjesëmarrjen e studentëve në debate për çështje publike, duke siguruar standarde të larta sjelljeje përkundrejt publikut.

Debat dhe pjesëmarrje politike. Misioni i klubit “Debat dhe pjesëmarrje politike” është t’u krijojë studentëve një mjedis diskutimi me profesionistë, analistë, studiues e protagonistë të politikës e të shoqërisë, rreth çështjeve me rëndësi në demokraci. Qëllimi i këtij klubi është t’u mundësojë studentëve jo vetëm të informohen e të diskutojnë mbi aspektet e jetës demokratike, por edhe të shprehin lirshëm e në mënyrë demokratike pikëpamjet e tyre mbi demokracinë. Përmes këtyre debateve, studentët do të mund të vlerësojnë e zhvillojnë aftësitë dhe ambiciet e tyre në fushën politike e sociale, e do të shfaqin aftësitë e tyre të drejtimit, të punës në grup, të të folurit publik, të të dëgjuarit kritik, të kontrollit të emocioneve dhe të tolerancës.